

VENDIM
Nr.724, datë 1.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS MACUKULL TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Macukull të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Macukull të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.789, datë 4.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Macukull, të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Macukull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Macukull

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-3	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
4-5	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
6	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
16-35	Varrezat publike	Në pronësi
37-43,45,46,48	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
44,47	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të	Në pronësi

	ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta).	
--	---	--